

2

GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje ndaj Brikena Mulliqi, zyrtare e Lartë në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar 04/L-050 , në bazë të nenit 73,74, 195,dhe nenit 198 al.1 pika 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79 (LK), me datë **31.10.2011** merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET Kërkesa e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) **01-4109/2011** e parashtruar në këtë gjykatë me datë **26.10.2011** ndaj **Brikena Mulliqi, U.D.** Drejtor i Zyrës për Integritet Evrpiane, në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar,

Pezullimi bëhet komfor nenit 198 al.1 pika 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, pasi që Agjencia Kundër Korrupsionit si parashtrues i kërkesës, me datë 31.10.2011, me shkrim ka parashtruar Kërkesë me të cilën precizohet dhe dëshmohet se zyrtarja Brikena Mulliqi **KA** deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor. Andaj, meqë parashtruesi i Kërkesës ka Heqë Dorë nga Kërkesa, gjyqtarja vlerësoi se komfor nenit 198 al.1 pika 10 janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës ndaj të njëjtës.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur,

Një kopje të këtij aktvendimi i dorëzohet parashtruesit të kërkesës.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Llog. / Adresa / Nr. i fletës / Grupi i çështjes / Nr. i pages	Nr. Prot. / B. Prot. / Prot. No. / Data / Bashk. / Data / PRISHTINE
D.P	03-4534/11 18.11.2011

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë i parashtrroi kësaj gjykate Kërkesën me nr. të rastit 01-4109/2011 të datës 24.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të lartshënuarës për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kjo kërkesë është pranuar në këtë gjykatë me datë 26.10.2011 dhe është protokoluuar me nr.37310/2011.

Agjencia Kundër Korrupsionit, në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate Shkresë 01-4208/2-11 me datë 31.10.2011. Kjo Shkresë është pranuar në këtë gjykatë me datë 31.10.2011 dhe është protokoluuar me numër të njëjtë sikur Kërkesa e lartshënuar.

Nga të dhënat e parashtruara në Shkresë të AKK, gjyqtarja komfor nenit 198 al.1 pika 10 e LK e Pezulloi Kërkesën pasi që konstatoi se në Agjencinë Kundër Korrupsionit është bërë gabim teknik gjatë procesimit të emrave të zyrtarëve dhe se zyrtarja Brikena Mulliqi KA deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor, për çka edhe është dëshmuar me Vërtetimin 03/3661/2011 për dorëzimin e formularit për deklarim brenda afatit ligjor të nënshkruar dhe të protokoluuar me datë 15.09.2011, andaj gjyqtarja duke vlerësuar se parashtruesi i Kërkesës ka hequr dorë nga Kërkesa, komfor nenit 198 al.1 pika 10 të LK pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj të lartshënuarës. Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr.regj. 37310/2011, me datë 31.10.2011

Gjyqtarja
Suzana Çerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate dhe pa taksa.